



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Laç, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**Shtojca 12**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT  
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data.13.05.2026

**Drejtuar:** Bashkimit të operatorëve ekonomikë “AIDA CONSTRUCTION” SHPK & “TEA-D” SHPK:

- “AIDA CONSTRUCTION” SHPK me numër NIPTI **M03116403L**, marrë përsipër punimet në masën 93%, **Adresa:** Fier Fier FIER Rr BRIGADA XI SULMUESE, LAGJIA APOLONIA, pallati ne krah te Drejtorise Rajonale te Tatimeve, 9301, Bashkia Fier.
- “TEA-D” SHPK, me numër NIPTI **K32522629L**, marrë përsipër punimet në masën 7%, **Adresa:** Gjirokaster Libohove LIBOHOVE Rruga "Dhuvjan", nr.pasurie 3105, ZK 2444.

**Me subjekt Mbështetës:** Operatori ekonomik “6D - PLAN” SHPK, me numër NIPTI **L62717405H**, Adresa: Tirane Tirane TIRANE Rruga "Dritan Hoxha", Pallati 117, përballë ProCredit, Laprakë, Hyrja 2, Kati 2, Tiranë.

**Tipi i Kontratës:** Punë

**Lloji i Procedurës së prokurimit:** “Procedurë e hapur”

**Numri i procedurës / referenca e Lotit:** **REF-73562-12-30-2025**

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Rikualifikim urban i hapesirave publike në lagjen Nr.1 Laç”.

**Fondi limit:** **32,081,292.67** (tridhjetë e dy milion e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 180 ditë / 6 muaj.

**Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:** 31.12.2025

**Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike:** Nr.85, datë 31.12.2025.

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

1

**Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:**

1. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“L.T.E CONSTRUCTION” SHPK** me numër NIPTI **L78006801F & “VARAKU E” SHPK**, me numër NIPTI **J61902509S**.  
**Vlera e ofertuar: 23,876,172.60** (njëzet e tre milion e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy pikë gjashtëdhjetë) lekë **pa TVSH**.
2. Operatori ekonomik **“XHAŠT SHPK” SHPK**, me numër NIPTI **K12512837I**.  
**Vlera e ofertuar: 24,318,189** (njëzet e katër milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë **pa TVSH**.
3. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“AIDA CONSTRUCTION” SHPK** me numër NIPTI **M03116403L & “TEA-D” SHPK**, me numër NIPTI **K32522629L**.  
**Me subjekt Mbështetës: Operatori ekonomik “6D - PLAN” SHPK**, me numër NIPTI **L62717405H**.  
**Vlera e ofertuar: 25,284,798** (njëzet e pesë milion e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë **pa TVSH**.
4. Operatori ekonomik **“INA” SHPK** me numër NIPTI **J61814009W**.  
**Vlera e ofertuar: 25,659,974** (njëzet e pesë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë **pa TVSH**.
5. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK** me numër NIPTI **K82230002K & “STERKAJ” SHPK**, me numër NIPTI **J68310708M**.  
**Vlera e ofertuar: 25,717,713** (njëzet e pesë milion e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e trembëdhjetë) lekë **pa TVSH**.
6. Operatori ekonomik **“DESARET COMPANY” SHPK**, me numër NIPTI **K01816001J**.  
**Vlera e ofertuar: 27,579,259.68** (njëzet e shtatë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë **pa TVSH**.
7. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“NDREGJONI” SHPK** me numër NIPTI **K31329048I & “RAFIN COMPANY” SHPK**, me numër NIPTI **L52125110A**.  
**Vlera e ofertuar: 27,936,857** (njëzet e shtatë milion e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë **pa TVSH**.
8. Operatori ekonomik **“BAMI HOLDING” SHPK**, me numër NIPTI **J94416206R**.  
**Vlera e ofertuar: 28,704,936.75** (njëzet e tetë milion e shtatëqind e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë **pa TVSH**.
9. Operatori ekonomik **“LIQENI VII” SHPK**, me numër NIPTI **K01730502W**.  
**Vlera e ofertuar: 29,645,710.50** (njëzet e nëntë milion e gjashtëqind e dyzet e pesë mijë e shtatëqind e dhjetë pikë pesëdhjetë) lekë **pa TVSH**.

## **Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “**L.T.E CONSTRUCTION**” SHPK me numër NIPTI **L78006801F** & “**VARAKU E**” SHPK, me numër NIPTI **J61902509S**.

### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ...., si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

### **1. OE nuk plotëson pikën 2.3.6.A të DST:**

**KVO konstatoi se:** BOE “L.T.E CONSTRUCTION” SHPK & “VARAKU E” SHPK nuk plotëson pikën 2.3.6.A të DST (për Karpentier, Betonues, Hekurkthyes, Punëtor shtrim pllake) konkretisht pikën 2.3.6.A, nuk e plotëson OE “VARAKU E” SHPK.

Referuar Kontratës për bashkëpunimin e përkohshëm të shoqërive tregtare, Nr.004 Prot, datë 27.01.2026, si dhe preventivit të ndarjes së punimeve, rezulton se OE “VARAKU E” SHPK ka marrë përsipër të kryejë 10% të punimeve për çdo zë në preventive. Ndërsa tek shtojca 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, konstatohet se në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur , OE “VARAKU E” SHPK nuk ka deklaruar asnjë specialist karpentier, asnjë specialist betonues, asnjë specialist hekurkthyes si dhe asnjë specialist punëtor shtrim pllake.

Autoriteti Kontraktor në DST tek pika 2.3.6.A, ka kërkuar:

***A. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet disponoje pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontrate punës të vlefshme, deshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi /IQT të vlefshme si dhe duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise per periudhen 3 muajt e fundit të deklaruar (shtator-tetor-nentor 2025):***

- Karpentier 3 (tre)
- Betonues 2 (dy)
- Hekurkthyes 1 (një)
- Punëtor shtrim pllake 6 (gjashtë)

Në nenin 88, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: ***3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në***

*përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Për sa më sipër, përderisa OE “VARAKU E” SHPK nuk ka deklaruar asnjë specialist karpentier, asnjë specialist betonues, asnjë specialist hekurkthyes si dhe asnjë specialist punëtor shtrim pllake, edhe pse në aktmarrëveshje ka marrë përsipër të realizojë 10% të punimeve për çdo zë në preventiv, KVO e skualifikon pasi nuk plotëson pikën 2.3.6.A të DST, kriter ky i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

## 2. Operatori ekonomik “XHAŠT SHPK” SHPK, me numër NIPTI K12512837I.

### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit .....**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”,** oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “XHAŠT SHPK” SHPK, dokumentacion i cili u protokollua në Bashkinë Kurbin me Nr.6200/14 Prot, datë 22.04.2026, konstatoi se operatori ekonomik **nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST, konkretisht pikat 2.2.3, 2.3.9 dhe 2.3.6.B të DST**, si më poshtë:

**Së pari:** Operatori ekonomik “XHAŠT SHPK” SHPK nuk plotëson pikën 2.2.3 të DST, pasi nuk ka paraqitur Vërtetim Për Likuidimin e Detyrimeve Vendore për Bashkinë Kavaje si dhe për Bashkinë Lezhë.

Sqarojmë se pas verifikimit të dokumentacionit (Ekstraktit Historik) KVO konstatoi se operatori ekonomik “XHAŠT SHPK” SHPK ka të hapur aktivitet me zyrë qendrore në adresën: *Tirane Kavaje Tirane Kavaje Kavaje Golem Kryemedhenj zone kadestrale 2291 nr pasurie 373/70 vol 43 fq 83*. Gjithashtu referuar QKB me datë 13.08.2025 OE ka hapur aktivitet në Bashkinë Lezhë, në adresën: *Lezhe, Njësia Administrative Shenkoll, Nj.a Shengjin.....etj*, si dhe me datë 24.09.2025 ka hapur aktivitet po në Bashkinë Lezhë, në adresën: *Lezhe, Tale Lezhë*.

Autoriteti Kontraktor në DST, tek pika 2.2.3 ka kërkuar se: ***2.2.3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument qe verteton se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2025 (referuar QKB) sipas percaktimeve ne ligjin 9632/2006” Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.***

Sa më sipër del qartë se OE duhet të kishte paraqitur Vërtetim Për Likuidimin e Detyrimeve Vendore për Bashkinë Kavaje si dhe për Bashkinë Lezhë, kritere këto të përcaktuara nga AK në DST.

**Së dyti:** Operatori ekonomik “XHAŠT SHPK” SHPK nuk plotëson pikën 2.3.9 të DST, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për mjetin Fadrome me goma sipas kërkesave të përcaktuara në DST nga Autoriteti Kontraktor.

Për **Fadrome me goma** operatori ekonomik ka paraqitur: *Shkresën Nr.1368 Prot, datë 22.05.2008 “Leje Qarkullimi Provizore” leshuar nga Komisariati i Policisë Durrës (me afat përdorimi 10 ditë), Akt Zhdoganimi numer R36143 datë 22.05.2008 si dhe Foto (ku duket qartë se është mjet me goma)*

Sqarojmë se mungon dokumentacioni përkatës si: Leje Qarkullimi, Çertifikatë Pronësie, Policë, Taksat Vjetore, Çertifikatë të Kontrollit Teknik, pasi ky është mjet me goma dhe mjetet me goma duhet të kenë dokumentacion për të qarkulluar në rrugë, kritere këto të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

**Së treti:** Gjithashtu operatori ekonomik “XHAŠT SHPK” SHPK nuk plotëson pikën 2.3.6.B të DST, për sa më poshtë vijon:

Pas verifikimit të dokumentacionit (kontratave të punës), KVO konstatoi se tre punonjës të citët OE i ka deklaruar për pikën 2.3.6.B të DST, konkretisht (z. *Abdallah Ibrahim Fatthy Ibrahim, z.Ahmed Abdelhamid Gad Moustafa Mohaned dhe z.Ahmed Samir Abdelraouf Mellawy*) janë punësuar si Kamarier, Pjatararës dhe Banakier. Pra del qartë se nuk janë punonjës të cilët kryejnë punë ndërtimi sipas objektit të prokurimit.

**Për sa më sipër, KVO nuk mund të kualifikojë një operator ekonomik, i cili nuk plotëson/paraqet dokumentacionin sipas kërkesave që Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar në DST.**

**Si përfundim,** në mbështetje të nenit 92, të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe të nenit 82, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik “XHAŠT SHPK” SHPK, **S’Kualifikohet.**

3. Operatori ekonomik “INA” SHPK me numër NIPTI J61814009W.

#### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ...., si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të**

përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

**1. OE nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST (për punë të ngjashme):**

**KVO konstatoi se:** OE “INA” SHPK nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST (për punë të ngjashme).

Pasi verifikuam dokumentacionin që OE ka ngarkuar në SPE, rezulton se ky operator ka marrë përsipër ta realizojë i vetëm të gjithë kontratën objekt prokurimi.

Për kontratë të ngjashme OE “INA” SHPK, ka ngarkuar në SPE, vetëm 1 (një) kontratë për të cilën ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

1. *Kontratë Nr.4500507657, me objekt: Punime civile mekanike KRAKOW-BALICE POLAND, të lidhur me Agjencinë e Natos për mbështetjen dhe Prokurimin (më tej e cilësuar NSPA)*
2. *Çertifikatë Pranimi, datë 04.03.2024*
3. *Email datë 02.09.2024 dhe datë 04.09.2024.*
4. *Deklaratë për punën e ngjashme lëshuar nga OE INA.*

Ndërsa Autoriteti Kontraktor në DST tek pika 2.3.1, ndër të tjera ka kërkuar: ..... *Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:*
- *Kontratë Sipërmarrje*
- ***Situacionin përfundimtar (me zëra punimesh);***
- *Aktin e kolaudimit;*

KVO pasi verifikoi dokumentacionin që OE “INA” SHPK, ka paraqitur për kontratë të ngjashme, konstatoi se ky OE nuk ka paraqitur **Situacionin përfundimtar (me zëra punimesh)**, gjithashtu nuk ka paraqitur asnjë preventiv që të vërtetojë se çfarë pune ka realizuar, si dhe nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër me vërtetu se çfarë zëra punimesh ka realizuar, në menyre që komisioni të bindet se kjo kontratë është e ngjashme me objektin e prokurimit që Autoriteti Kontraktor ka prokuruar.

Sqarojmë se tek *Kontrata Nr.4500507657, me objekt: Punime civile mekanike KRAKOW-BALICE POLAND*, që OE ka paraqitur, në faqen 2 të saj, tek TABELA E PËRMBAJTJES shkruhet ndër të tjera shprehimisht se: *Kjo kontratë përbehet nga: ..... Shtojca D: Preventivi i sasive..... Shtojca H: Propozimi/Oferta e Kontraktorit..... të gjitha këto janë pjesë e kontratës.....*etj. Dokumentacion të cilin OE nuk e ka paraqitur në SPE.

Del qartë se kontrata e ngjashme që ka paraqitur OE “INA” SHPK, nuk është e plotë, pra nuk është bindëse si dhe nuk garanton AK për realizimin e kontratës me sukses, pasi ky OE nuk ka provuar se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit që Autoriteti Kontraktor ka prokuruar.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatorëve ekonomikë **“AIDA CONSTRUCTION” SHPK**, me adresë: Fier Fier FIER Rr BRIGADA XI SULMUESE, LAGJIA APOLONIA, pallati ne krah te Drejtorise Rajonale te Tatimeve, 9301, Bashkia Fier & **“TEA-D” SHPK**, me adresë: Gjirokaster Libohove LIBOHOVE Rruga "Dhuvjan", nr.pasurie 3105, ZK 2444, **Me subjekt Mbështetës: Operatori ekonomik “6D - PLAN” SHPK**, me adresë: Tirane Tirane TIRANE Rruga "Dritan Hoxha", Pallati 117, përballë ProCredit, Laprakë, Hyrja 2, Kati 2, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **25,284,798** (njëzet e pesë milion e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë **pa TVSH**, është identifikuar si fitues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

**Titullari i Autoritetit Kontraktor  
Majlinda CARA**